



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

KRYETARI

Nr. 20 Prot.

Tiranë, më 10/04/2018

VENDIM

Nr.1 dt. 26.03.2018

“Për Heqjen Dorë të Anëtares së K.E.D znj. Rovena Gashi”.

Sot më datë 26 .03.2018 si u njoha me kërkesën e paraqitur nga Anëtarja e K.E.D. znj, Rovena Gashi

KONSTATOVA se:

Znj. Rovena Gashi është zgjedhur Anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (*më poshtë K.E.D.*) nga shorti i zhvilluar më datë 07.12.20107 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

K.E.D. më datë 19.03.2018 ka zhvilluar mbledhjen e parë të tij ku ndër të tjera është vendosur: Hartimi i Rregulloreve të K.E.D.

Në kërkesën e paraqitur znj. Gashi shpjegon se ka shfaqur interes për dy vëndet vakante të shpallura nga Presidenti i Republikës për Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Duke qenë se K.E.D. është në fazën e Hartimit të Rregulloreve e konkretisht edhe të asaj që përcakton kriteret e pikëzimit të kandidatëve për Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe duke qenë se znj.Gashi ka kandiduar në 2 vakancat e shpallura nga Presidenti i Republikës çmoj se ka vënd që Anëtarja e K.E.D znj.Gashi ka një konflikt interesi në dukje, pasi pasi nuk mund të marrë pjesë në diskutimet apo dhe vednimmarje të përcaktimit të kriterëve të pikëzimit për kandidatët për Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese e gjithashtu nuk mund të marrë pjesë as në shortin dhe zhvillimin e procedurës që do të zhvillohet për 2 vakancat e shpallura nga Presidenti i Republikës .

Për Këto Arsye

Mbështetur në Nenin 224/2 të Ligjit Nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë"

VENDOSA

-Pranimin e kërkesës për heqje dorë të znj. Rovena Gashi nga diskutimi, propozimi dhe miratimi i Regullores së K.E.D. për përcaktimin e kriterëve të pikëzimit të kandidatëve për Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nga procedura e shortit për përzgjedhjen e Relatorit për 2 vakancat e shpallura nga Presidenti i Republikës, për Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

-Publikimi i këtij vendimi në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë.

Tiranë më, 26.03.2018.

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Artan BROCI

